

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit dhe gjyqtarëve: Agim Maliqi dhe Valdete Daka, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit A.R., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm P.nr.4436/2016 të datës 16.11.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.1nr.76/2018 të datës 03.04.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 01 tetor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A.R., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.4436/2016 të datës 16.11.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.1nr.76/2018 të datës 03.04.2018.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm me aktgjykimin P.nr.4436/16 të datës 16.11.2017, të dënuarin A.R., e ka shpallur fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së dhe e ka

grykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 17.02.2016 deri me datë 25.02.2016. Është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 € dhe shpenzimeve të procedurës penale në shumë prej 100 €, ndërsa të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PA.1nr.76/2018 të datës 03.04.2018, ka miratuar pjesërisht ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë vetëm përkitazi me llogaritjen e arrestit shtëpiak, kurse pjesët tjera të aktgjykimit kanë mbetur të paprekura.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A.R., av. Zh.J. nga Prishtina, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarit ti shqiptoj dënim me kusht.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson, se në trupin gjykues të gjykatës së shkallës së dytë ka marrë pjesë gjyqtari Hashim Çollaku i cili po ashtu ka marrë pjesë edhe gjatë procedurës paraprake përkatësisht në kolegjin penal i cili ka vendosur përkitazi me heqjen e paraburgimit dhe caktimin e masës së arrestit shtëpiak.

Më tutje pretendohet se me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar dispozitat e qëllimit të dënimit të përcaktuara me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së, meqë po të vlerësohej qëllimi i dënimit në rastin konkret ky qëllim do të arrihej edhe përmes dënimit të kushtëzuar. I dënuari është person pa të kaluar kriminale, se bëhet fjalë për vepër

penale nga pakujdesia dhe po ashtu pala e dëmtuar jo vetëm që nuk i është bashkëngjitur ndjekjes penale por nga gjykata ka kërkuar që i dënuari të mos dënohet.

Në kërkesë pretendohet po ashtu se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë në kundërshtim me ligjin, me rastin e çmuarjes së rrethanave rënduese, mes tjerash si rrethanë rënduese kanë marrë pasojën e veprës penale. Po ashtu edhe me rastin e vlerësimit të rrethanave lehtësuese të njëjtat vetëm janë konstatuar dhe nuk janë vlerësuar mjaftueshëm siç është pranimi i fajësisë, personaliteti i të dënuarit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe sjellja e të dënuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale e që po të vlerësoheshin mjaftueshëm me siguri se dënimi do të zbutej.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.166/2018 të datës 19.09.2018, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe, pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj se pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i pabazuar edhe pse është i saktë fakti se në përbërjen e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë ka marrë pjesë gjyqtari Hashim Qollaku dhe atë anëtar i kolegjit penal duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësi të të dënuarit dhe i cili po ashtu paraprakisht ka marrë pjesë edhe në fazën paraprake si kryetar i kolegjit me rastin e heqjes së paraburgimit dhe caktimin e arrestit shtëpiak ndaj të dënuarit. Megjithatë në rastin konkret nuk është shkelur dispozita e nenit 39 par.2 të KPPK-së meqë në rastin konkret anëtari i kolegjit penal nuk ka vendosur për caktimin përkatësisht vazhdimin e masës së paraburgimit por heqjen e kësaj mase.

Pretendimi se në rastin konkret është shkelur ligji penal pasi që të dënuarit i është shqiptuar dënim i ashpër dhe joproporcional dhe se me rastin e çmuarjes së rrethanave rënduese është marrë edhe elementi i veprës penale se ka humbur jetën një person, nuk është i bazuar që gjykata e shkallë së parë ka marrë për bazë të gjitha rrethanat relevante me rastin e shqiptimit të dënimit dhe si rrethanë rënduese ka marrë faktin se në rastin konkret pos faktit se ka humbur jetën një person, kurse lëndime të rënda trupore kanë marrë tre të dëmtuar të tjerë e po ashtu lëndime të lehta trupore kanë marrë edhe tre të dëmtuar të tjerë.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatojë se konform dispozitës se nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar llojin e dënimit të paraparë për këtë veprë penale gjegjësisht dënimin me burgim brenda minimumit dhe maksimumit të paraparë me ligj, kështu që pretendimi i të dënuarit i paraqitur në kërkesë se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të ligjit penal nuk është i bazuar.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishe e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Pml.nr.242/2018, më datë 01 tetor 2018

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetarja e kolegjit,
Nesrin Lushta